


**BULETINI TREMUJOR**  
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



**TRUSTORJA**

## PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1V	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-0.17%	+0.49%	+4.44%	+13.53%	+32.96%	<b>+37.56%</b>
BENÇMARKU*	+0.30%	+1.40%	+1.30%	+0.67%	+4.94%	<b>+32.80%</b>

\*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

## PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM4 2016

### ÇMIMI I AKSIONIT:

TETOR	▼ -1.00%
NËNTOR	▼ -0.01%
DHJETOR	▲ +1.51%
<b>GJITHSEJ PERFORMANCA NETO</b>	<b>▲ +0.49%</b>

### KTHIMI BRUTO:

TETOR	-€13.26 mln
NËNTOR	-€0.49 mln
DHJETOR	+€21.59 mln
<b>GJITHSEJ KTHIMI BRUTO</b>	<b>+€8.77 mln</b>

## FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT  
€1.3756

MJETET NETO NËN MENAXHIM  
€1,417,970,874

PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR  
€4.33 mln

PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT  
€19.21 mln

LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR  
927

LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT  
4,405

LLOGARI TË KONTRIBUESVE  
541,923

LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUdhËS  
312,672

KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT  
34,009

KONTRIBUTE KËTË VIT  
€151.50 mln

SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT  
81,514

GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI  
61,735

## PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES PËR TM4 2016

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA	KONTRIBUIMI NË PERFORMANCË
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€395,450,768	27.88%	+4.40%	+1.15%
Nordea	1-Stable Return Fund	€232,257,002	16.37%	-2.22%	-0.38%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€170,162,279	11.99%	+4.39%	+0.52%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€138,826,337	9.79%	-5.17%	-0.86%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€85,653,672	6.04%	-2.76%	-0.17%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€78,697,946	5.55%	+0.60%*	+0.03%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€61,183,827	4.31%	+2.41%	+0.11%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€58,778,067	4.14%	+3.34%	+0.10%
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€50,872,418	3.59%	+2.19%	+0.06%
Amundi	Rendement Plus Part I2	€50,255,615	3.54%	-0.06%	+0.02%
Parvest	Diversified Dynamic	€50,091,737	3.53%	-0.54%	+0.01%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€10,209,928	0.72%	+1.29%	+0.01%
Banka Kombëtare Tregtare	Depozitë me afat	€8,005,071	0.22%	+0.06%**	+0.00%
Banka për Biznes SH.A.	Depozitë me afat	€8,006,707	0.56%	+0.08%**	+0.00%
TEB SH.A.	Depozitë me afat	€4,001,311	0.56%	+0.03%**	+0.00%
<b>GJITHSEJ MJETE TË INVESTUARA</b>		<b>€1,402,452,685</b>	<b>98.86%</b>	<b>+0.49%</b>	<b>0.60%</b>

\*Performanca në këto raste është për çështje ilustrimi dhe nuk lidhet me investimin, pasi janë depozita me afat, me interes të paracaktuar.

\*\*Ky kthim nga investimet nuk përkon me gjithë periudhën e TM4. Këto depozita me afat në tri banka në Kosovë janë bërë gjatë muajit dhjetor 2016.

## €64.6 MLN KTHIMI BRUTO PËR 2016

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës e përmbylli edhe një vit me rezultat pozitiv në të gjitha fushat e operimit. Për vitin 2016 kthimi bruto nga investimet ishte 65 milionë euro dhe çmimi i njësisë u ngrit për 4.44%. Në fund të 2016-s mjetet neto që FKPK-ja kishte nën menaxhim iu afruan vlerës së 1.42 miliardë eurove, ose një rritje prej 189 milionë euro nga fundviti i kaluar. Në rritjen e mjeteve nën menaxhim ndikuan: kontributet e reja me 152 milionë euro dhe kthimi nga investimet prej 64.6 milionë euro. Ndërkohë për të njëjtën periudhë: për pension u shpagueu 19 milionë euro, për tarifa menaxhuese 6 milionë euro dhe u refonduan 2 milionë euro.

### FAKTORËT ME NDIKIM

Ky rezultat pozitiv u arrit në një vit i cili ishte mjaft sfidues për shkak të një ambienti ekonomik me norma të ulëta të interesit dhe me çka asetet me risk të ulët nuk u shpërblyen mjaftueshëm; me tregun evropian të aksioneve i përballur me paqartësitë e rezultatit të BREXIT, dhe me gjendjen nervoze të aksioneve në nivel global në pritje të zgjedhjeve presidenciale në SHBA dhe ndryshimeve të mundshme të politikës monetare nga FED. Përkundër luhatshmërive dhe sfidave, tregjet financiare ia dolën mjaft mirë dhe shumë indekse arritën të dalin në territor pozitiv vetëm gjatë muajit të fundit të vitit. Kjo performancë u mbështet nga përmirësimi gradual i treguesve ekonomikë në nivel global, së bashku me ngritjen e çmimit të naftës. Në këtë rast Bordi Drejtues është mjaft i kënaqur me performancën e investimeve, e cila provoi qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e strategjisë investuese në fuqi, duke ofruar kombinim të stabilitetit dhe kthimit përmes balancimit të investimeve dhe diversifikimit.

### PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Ky ishte një tremujor më specifik për faktin se kishim dallim shumë të vogël mes performancës investuese të fondeve. Diferenca mes performancës më të mirë (të Vanguard +1.15%) dhe performancës më të dobët (të BNY Mellon -0.86%) ishte vetëm 2 përqind. Për më shumë, 6 nga 12 fondet investuese të angazhuara ishin brenda segmentit të kthimi nga investimet prej +0.01% dhe +0.11%. Performanca jo e mirë e klasës së fletobligacioneve la shenjë më së së shumti në fondin e përzier të BNY Mellon dhe më pak tek Nordea SRF (-0.38%), ndërsa niveli i ulët i inflacionit global u reflektua negativisht në portofolin e AXA GILB (-0.17%).

Duke anashkaluar këtë tremujor, viti 2016 ishte pozitiv për të gjitha fondet e angazhuara nga FKPK-ja. Performancën më të mirë për vitin e kishte fondi i Nordea GSEF (+11.3%), i ndjekur nga fond i Pictet (+8.63%), ndërsa performancën më të ulët e kishte fondi i BNY Mellon (+2.05%) dhe fondi i Amundi (+2.22%). Por përtej kësaj, kur vlerësojmë kontributin që kishte secili fond në totalin e kthimit nga investimet, del se Vanguard, në klasën e aksioneve, kontribuoi më së shumti (reth 43%), duke pasur njëkohësisht edhe alokimin më të lartë të fondeve. Kontributin më të ulët, nga fondet e angazhuara deri në fund të vitit, e kishte Schorders SB (-0.10%), që ishte në klasën e fletobligacioneve.

Investimet në Kosovë ishin me norma të paracaktuara të interesit. Këto investime kontribuan mesatarisht në performancën e përgjithshme me 1.2%.

#### PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE NË TM4

+0.49%

#### PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE PËR VITIN

+4.44%

## LAJMET KRYESORE TË TREMUJORIT

### AMUNDI I SHTOHET LISTËS INVESTUESE

Pasi ishte përzgjedhur në korrik, përmes thirrjes ndërkombëtare për oferta, Amundi nisi prej dhjetorit menaxhimin e një pjesë të mjeteve të FKPK-së përmes fondit investues Amundi Rendement Puls I2. Ky fond, që tregton me aksione dhe me më shumë fletobligacione, përmes menaxhimit aktiv të riskut synon të mbajë luhatshmërinë vjetore të portofolit nën 4%. Amundi, me seli në Paris, Francë, është themeluar më 2010 nga Crédit Agricole dhe Société Générale, për t'i rigrupuar operacionet e tyre të menaxhimit të aseteve nën një kulm. Për nga shuma e mjeteve nën menaxhim, Amundi renditet në krye të listës së aset-menaxherëve në Europë.

### BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E FUNDIT PËR 2016

Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2016, pasi ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, ka marrë këto vendime: 1) Të investojë në depozitat një vjeçare si në vijim: €8 mln në BPB; €8 mln në BKT; dhe €4 mln në TEB; 2) Të shesë €65 mln nga BNY Mellon; 3) Të investojë: €20 mln në Vanguard; €15 mln në Pictet; nga €10 mln në secilin nga fondet e Amundi, BNP Parvest dhe në Schroders GDG.

### KUVENDI I MIRATOI TARIFAT PËR 2017

Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016 ka miratuar tarifën operacionale prej 0.081% dhe tarifën investuese prej 0.393% që FKPK-ja do t'i ngarkojë mbi fondin për vitin 2017.

Tarifat e vitit 2017 janë vendosur kështu më të ulëta sesa ato që ishin për vitin 2016, përkatësisht: 0.082% tarifa operacionale dhe 0.398% tarifa investuese.

### KONTRIBUTET E PAALOKUARA ZBRESIN NË 0.75%

Kontributet e paalokuara në llogari, pra për të cilat FKPK-ja nuk ka informacion se për kë janë paguar ose nëse janë kontribute, kanë rënë në fund të 2016-s në nivelin më të ulët historik prej 0.75% e totalit të kontributeve, ose rreth €9.45 mln në vlerë nominale.

Një vit më parë kontributet e paalokuara ishin në nivelin 0.90% e totalit të kontributeve, ose në vlerë nominale €9.97 mln.

### €19.2 MLN PENSIONE MË 2016

Më 2016 ishin edhe 4,405 llogari të pensionuara që tërhoqën €19.2 mln. Në fund të 2015-s kishin qenë 4,438 llogari të pensionuara dhe €19.3 mln.

Prej themelimit e deri më tani numri i llogarive të pensionuara arriti në 33,386 dhe vlera që kanë tërhequr këta përfitues të pensionit ka arritur në €91 mln.

### 27% MË SHUMË LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të 2016 arriti në 61,735 ose një rritje prej mbi 27% për një vit (fundviti 2015: 48,427 llogari). Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

**BOTUES:**

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës  
Shkurt 2017

**REDAKTOR:**

Vërshim Hatipi

**AUTOR:**

Jeton Demi

**KONTAKT:**

Rr. "Agim Ramadani" Nr. #182-184  
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025  
Zyra Qendrore: +381-38-600-020

[info@trusti.org](mailto:info@trusti.org)

[www.trusti.org](http://www.trusti.org)